



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education

Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2015, Për Normativ mbi Kuadrin e Arsimit Profesional dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ për Kuadër Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2019/20.

1. SHFMU" Gëzim Hamza-Piktori " në Rahovec.

Një mësimdhënës/e për Program Parafillor, me kohë të caktuar (deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë)

Një mësimdhënës/e për lëndën e Biologjisë, me kohë të caktuar (deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë)

2. SHMLP" Selajdin Mullaabazi-Mici" në Rahovec

Një mësimdhënës/e për Lëndën e Matematikës, me kohë të caktuar (deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë)

Kushtet për konkurrim:

Për vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas U.A. 05/2015 (Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin e Arsimit Profesional) si dhe U.A.10/2018, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkangjitur dokumentet përkatëse, në zyrat e DKA-së.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime

Informata shtesë:

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.
- Dokumentet pranohen deri më datë, 16.12.2019, deri në ora 15.00
- Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më datën 18.12.2019 në objektin e SHMLP" Selajdin Mullaabazi-Mici" në Rahovec, duke filluar nga ora 10.00.
- Intervistimi me gojë i kandidatëve do të realizohet me datë, 20.12.2019, në DKA duke filluar nga ora 10.00.

Rahovec,
02.12.2019

V.V

Avni Morina, Drejtor